



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve “Agi Kons” shpk & “Edil-Al-IT” shpk.**

**Adresa: Farke SELITE Kodra e Diellit II, Godine e kombinuar 4 kat+ 1 kat nentoke, nr. pasurie 51/159, Tiranë.**

**Adresa: Rruga Perlat Rexhepi, Ndertesa 1, Hyrja 14, Ap 7, Njesia Bashkiake nr 5, Kodi Postar 1019, Tiranë.**

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e Hapur” “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga Rr. ”Llambi Bonata”, Rr. ”Haki Stermilli”, ”Musine Kokalari” dhe rikonstruksion i rrugës ”Zyber Zeneli” vazhdim i rrugës ”Ali Kelmendi”

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga Rr. ”Llambi Bonata”, Rr. ”Haki Stermilli”, ”Musine Kokalari” dhe rikonstruksion i rrugës ”Zyber Zeneli” vazhdim i rrugës ”Ali Kelmendi”.

**Fondi limit:** 101,887,644 (njëqind e një milion e tetëqind e tetëdhjete e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve me Vendimin Nr. 8, datë 13.02.2017 “Për shpërndarjen e financimit për projekte, Thirrja e katërt për vitin 2016, të grantit “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”, programi zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale”, Shtylla I, përcjellë për kompetencë me shkresën me Nr. 7379 Prot. datë 23.02.2017.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 8 (tetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 27.06.2017, ora 11:00.

**Publikime të mëparshme:** (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 22 datë 05.06.2017.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Senka/L” shpk**

**NUIS J94808405Q**

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë pa TVSH.

**2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Mane/S” shpk**  
NUIS L61621008A

Vlera e ofertës = **79,854,633** (shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Agri Konstruksion” shpk & “Bajrami N” shpk**

NUIS K01725001F                      NUIS K027272020

Vlera e ofertës = **83,345,133.94** (tetëdhjetë e tre milion e treqind e dyzetë e pesë mijë e njëqind e tridhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “B93” shpk & “Piervis” shpk**

NUIS L522090500                      NUIS K12410001Q

Vlera e ofertës = **84,074,923** (tetëdhjetë e katër milion e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzetë e tre ) lekë pa TVSH.

**5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Agi Kons” shpk & “Edil-Al-IT” shpk**

NUIS K21622001M                      NUIS J61911003I

Vlera e ofertës = **84,521,440.59** (tetëdhjetë e katër milion e pesëqind e njëzetë e një mijë e katërqind e dyzetë pikë pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

**6. Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk**

NUIS J62028009B

Vlera e ofertës = **84,805,991** (tetëdhjetë e katër milion e tetëqind e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**7. Operatori ekonomik “Curri” shpk**

NUIS J67902718S

Vlera e ofertës = **88,214,712** (tetëdhjetë e tetë milion e dyqind e katërbëdhjetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**8. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bahas” shpk & “Avduli” shpk**

NUIS J61827083D                      NUIS J66703306O

Vlera e ofertës = **88,569,144** (tetëdhjetë e tetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.

**9. Operatori ekonomik “2T” shpk**

NUIS K01731001M

Vlera e ofertës = **89,704,066.50** (tetëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e katër mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

**10. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Glavenica” shpk & “Shëndelli” shpk**  
NUIS K17710805A      NUIS K07924803N

Vlera e ofertës = **92,679,147** (nëntëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH.

**11. Operatori ekonomik “Arifaj” shpk**

NUIS J76418907K

Vlera e ofertës = **92,702,523** (nëntëdhjetë e dy milion e shtatëqind e dy mijë e pesëqind e njëzetë e tre) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:  
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Operatori ekonomik “Senka/L” shpk**

NUIS J94808405Q

- Operatori ekonomik “Senka/L” shpk nuk plotëson pikën c të kriterëve të vecanta të Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur Përshkrimin e Ofertës sipas Shtojcës 1.

**2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Mane/S” shpk**

NUIS L61621008A

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Mane/S” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/Eskavator me goma/ 2 copë”* pasi nga 2 eskavatorë me goma të kërkuar, operatori “Mane/S” ka paraqitur me dokumentacion të rregullt eskavatorin me goma me targë AA537NG dhe për eskavatorin e marrë me qera nëpërmjet kontratës Nr.2643.Rep, Nr.928.Kol ka paraqitur vetëm faturë zhdoganimit dhe jo dokumentacionin e kërkuar sipas pikes 16.a).

**3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Agri Konstruksion” shpk & “Bajrami N” shpk.**

NUIS K01725001F

NUIS K02727202O

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Agri Konstruksion” shpk & “Bajrami N” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Eskavator me goma/ 2 copë”* pasi rezulton që vetëm një eskavator plotëson dokumentacionin e kërkuar dhe për eskavatorët e tjerë të deklaruar janë paraqitur vetëm faturat e zhdoganimit.
- Operatori ekonomik “Agri Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Një punësim mesatar i të paktën 65*

(gjashtëdhjetë e pesë) personave, për periudhën Prill 2016 – Prill 2017”, pasi në bazë të ndarjes së pjesëmarrjes në përqindje, për këtë procedurë prokurimi duhet të ketë një punësim mesatar prej 34 punonjësish por referuar numrit të punonjësve të angazhuar në kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo ujit (Faza e dytë)” lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, rezulton të mbetet një numër i pamjaftueshëm punonjësish të pa angazhuar.

- Operatori ekonomik “Bajrami N” nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit..”* pasi për mjekun nuk ka paraqitur Librezën e Punës.
- Operatori ekonomik “Agri Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i perfshire ne licensen e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: a) Librezë pune (përkatëse), b) CV përkatëse, c) Kontrate punë e vlefshme (përkatëse), d) Diplomë”* pasi për Drejtuesin Teknik të Punimeve nuk ka paraqitur Librezën e Punës.
- Operatori ekonomik “Agri Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt), diplomë, CV, librezat e punës si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit..”* pasi për stafin inxhinierik të deklaruar, nuk ka paraqitur për asnjërin prej tyre Librezat e Punës.
- Operatori ekonomik “Agri Konstruksion” shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: ***“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”***, pasi për Drejtuesin Teknik ka paraqitur fotokopje të Diplomës, të pa noterizuar.

#### **4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “B93” shpk & “Pienvis” shpk.**

NUIS L52209050 NUIS K12410001Q

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “B93” shpk & “Pienvis” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 7 (shtatë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”* pasi nga 7 (shtatë) manovratorë të kërkuar është paraqitur dokumentacion për vetëm 6 (gjashtë).
- Operatori ekonomik “Pienvis” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 7 (shtatë) punonjës*

*manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit” pasi për manovratorët Ram Brahaj dhe Zylfi Ademi mungojnë respektivisht; Dëshmi Drejtimi dhe Kontrata e Punës.*

## **5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Arifaj” shpk**

**NUIS J76418907K**

- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit Teknik, pasi për 2 kontratat e ngjashme nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim dhe Aktin e Kolaudimit.
- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit Teknik: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimum 6 (gjashtë) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët: (2) dy punonjës elektrikist, (2) dy pllakashtrues”* pasi për punonjësit pllakashtrues dhe elektrikist ka mbaruar afati i vlefshmërisë së kartelave personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Vibrator”* pasi nuk ka deklaruar në shtojcën 9 mjetin Vibrator.
- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Eskavator me goma/ 2 copë”* pasi ka paraqitur dokumentacion të rregullt për vetëm 1 (një) eskavator.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “Agi Kons” shpk & “Edil-Al-IT” shpk**, me adresë: **Farke SELITE Kodra e Diellit II, Godine e kombinuar 4 kat+ 1 kat nentoke, nr. pasurie 51/159, Tiranë** dhe me adresë: **Rruga Perlat Rexhepi, Ndertesa 1, Hyrja 14, Ap 7, Njesia Bashkiake nr 5, Kodi Postar 1019, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **84,521,440.59** (tetëdhjetë e katër milion e pesëqind e njëzetë e një mijë e katërqind e dyzetë pikë pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **84,805,991** (tetëdhjetë e katër milion e tetëqind e pesë mijë e

nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH, siç parashikohet në Nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:** 19.07.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

